



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.451/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova, Kryesues, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me tri ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.02.2025, merr këtë,

#### V E N D I M

REFUZOHEN të pabazuara ankesat Anr.451/2025, Anr.456/2025, Anr.457/2025 të gjitha të datës; 07.02.2025, të parashtruara nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

#### A r s y e t i m

Me datën 07.02.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesat Anr.451/2025, Anr.456/2025, Anr.457/2025 të parashtruara nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

-Në ankesën Anr.451/2025, parashtruesi i ankesës thekson me datë 29 janar 2025, në ora 21:57/h, kandidatja për deputete nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, znj. Liza Gashi, ka publikuar video në rrjetin social Facebook, në të cilën në një nga sekuencat e kësaj video, vërehen disa fëmijë të mitur, nën moshën 15 vjeçare, të cilët përdorën nga e njëjta me qëllim të organizimit të fushatës zgjedhore dhe përfitimit të votave.

Ndonëse PZAP-i përmes vendimit Anr.273/2025, të datës 03.02.2025, ka shpallur përgjegjës subjektin politik LVV për shkak të shkeljes së kodit mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët dhe i ka shqiptuar dënimi me gjobë në lartësi prej 2,000.00€ dhe pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi, postimi vazhdon të jetë aktiv në profilin e znj. Liza Gashi.

-Në ankesën Anr.456/2025, parashtruesi i ankesës thekson më datë 26 janar 2025, në ora 21:22/h, kandidatja për deputete nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, aktualisht Ministre në Ministrinë e Drejtësisë, znj. Albulena Haxhiu, ka publikuar fotografi në rrjetin social Facebook të tubimit të mbajtur më datë 26 janar, në ora 18:00/h, në Prishtinë, lagja Sofalia, në SHMFU "Gjergj Fishta", ku në njërin nga këto fotografi të publikuara nga e njëjta, vërehet prania e një fëmije të mitur, nën moshën 15 vjeçare, pa prezencën dhe rrjedhimisht pa pëlqimin e prindërve të tij.

Ndonëse PZAP përmes vendimit Anr.213/2025, të datës 29.01.2025, ka shpallur përgjegjës subjektin politik LVV për shkak të shkeljes së kodit të mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët dhe i ka shqiptuar dënimi me gjobë në lartësi prej 2,000.00€ edhe pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi, postimi vazhdon të jetë aktiv në profilin e znj. Albulena Haxhiu

-Në ankesën Anr.457/2025, parashtruesi i ankesës thekson më datë 26 janar 2025, në ora 21:20/h, kandidatja për deputete nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, znj. Mimoza Kusari Lila, ka publikuar fotografi në rrjetin social Facebook të tubimit të mbajtur më datë 26 janar, në ora 14:00/h, në Komunën Junik, në "Restaurant Gjeravica", ku në njërin nga këto fotografi të publikuara nga e njëjta, vërehet prania e një fëmije të mitur, nën moshën 15 vjeçare, pa prezencën dhe rrjedhimisht pa pëlqimin e prindërve të tij.

Ndonëse PZAP përmes vendimit Anr.212/2025, të datës 24.01.2025, ka shpallur përgjegjës subjektin politik LVV për shkak të shkeljes së kodit të mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët dhe i ka shqiptuar dënimi me gjobë në lartësi prej 3,000.00€ edhe pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi, postimi vazhdon të jetë aktiv në profilin e znj. Mimoza Kusari Lila.

Si provë në ankesë ka bashkangjitur videon dhe fotot e postimeve.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka theksuar se konsiderojnë se PZAP ka vlerësuar drejtë vendimet e saj të para për kandidatët në fjalë dhe të njëjtëve nuk i ka jep detyrim që të bëjë evitimin e shkeljes në të ardhmen (ex nunc), çka këtë çështje e bën të gjykuar dhe ankesën të pas afatshme. Për më shumë, kandidatët Liza Gashi, Albulena Haxhiu Mimoza Kusari Lila, tashmë ka fshirë nga rrjetet sociale videon e tillë, dhe fotografit e tilla nuk ekzistojnë të publikuar edhe me tutje në rrjetin social facebook.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të

Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat Anr.451/2025, Anr.456/2025, Anr.457/2025 të datës; 07.02.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë e përbashkët A.nr.451/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore gjeti se:

### **Ankesat janë të pabazuara.**

Pretendimet ankimore të parashtruesit të tri ankesave të cekura më lartë, se përkundër vendimeve të PZAP-it postimet e kandidatëve të subjektit Politik LVV Liza Gashi, Albulena Haxhiu dhe Mimoza Kusari Lila janë ende aktive ku vërehen disa fëmijë të mitur duke marrë pjesë në fushatë zgjedhore, Paneli thekson se pretendimet e parashtruara me ankesa nga subjekti politik PDK janë të pabazuara, kjo pasi që janë prezantuar provat e njëjta për të cilat Paneli tashme ka marrë vendime dhe mbi bazën e provave të njëjta nuk mund të shqiptoj gjobë për subjektin politik LVV. Andaj Paneli thekson se nuk janë prezantuar prova që tregojnë se ende ekzistojnë postimet për të cilat pala pretendohet në ankesa, ndërsa nga hetimi që është bërë nga PZAP-i nuk rezulton se të njëjtat postime janë ende aktive në rrjetet sociale të kandidateve të theksuara si në ankesë.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës si dhe nga hetimi i ndërmarr nga PZAP-ja nuk ka arritur të dëshmoj se postimet ende janë aktive, qe do të thotë, se me provat e paraqitura nuk është vërtetuar se ka shkelje të dispozitave të lartcekura të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024, siç pretendohet në ankesat e lartcekura, dhe si të tilla të njëjtat i refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës  
Anr.451/2025, datë;10.02.2025



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.